

TÜV NORD CERT – Certifikimi i Sistemit të Menaxhimit të Mbrojtjes së Mjedisit sipas Standartit ISO 14001:2015



ISO 14001 është një Sistem për Menaxhimin e Mbrojtjes së Mjedisit i pranuar në të gjithë botën. Organizata/ Kompania e të gjitha llojeve, gjithnjë e në masë më të madhe, duan të arrijnë dhe të dëshmojnë një mjedis të mbrojtur dhe të jetueshem përmes mbikqyrjes së ndikimit të veprimtarive të veta, të produkteve ose shërbimeve, në mjedis. Kjo arrihet me ligje dhe sisteme gjithnjë e më të ashpra, zhvillimin e politikave ekonomike, dhe të masave të tjera për të nxitur mbrojtjen e mjedisit, si dhe me rritjen e përgjithshme të interesit të palëve të interesuara për çështjet e mjedisit duke i përfshirë në zhvillimin e qëndrueshëm.

Rëndësia e standardit

Shumë Organizata/Kompani janë duke aplikuar “auditet” për të vlerësuar efektin e veprimtarisë së tyre në mjedis. Këto “rishqyrtime” dhe “auditime” nuk mund t’i sigurojnë organizatës se efekti i veprimtarive të saj në mjedis, jo vetëm tani, por edhe në të ardhmen, do të përmbushë kërkesat e ligjit dhe politikave për mbrojtjen e mjedisit. Që kjo të jetë më produktive, ato duhet të zbatohen patjetër brenda Sistemit të Ndërtuar të Menaxhimit dhe të përbëjnë një tërësi me veprimtaritë e tjera të Administrimit të Kompanisë.

Norma ndërkombëtare ISO 14001:2015 i specifikon kërkesat për sistem të menaxhimit të mjedisit jetësor (Environmental Management System-EMS) që organizatës t’i mundësohet zhvillimi dhe aplikimi i politikës dhe informacionet mbi aspektet e rëndësishme mjedisore. Përvojat në aplikimin e sistemit të menaxhimit të mbrojtjes së mjedisit vërtetojnë se kjo është një kornizë e shkëlqyer për zhvillim inovativ I bazuar në idenë e mbrojtjes së mjedisit, parandalimin e ndotjes ose të mbrojtjes së resurseve me një fjalë të zhvillimit të qëndrueshëm. Ajo jep një kuadër për pikeveshtrim të strukturuar dhe sistematik të Menaxhimit të Raporteve në mes të organizatës dhe mjedisit. Ndërsa mjedisi është toka, ajri, uji, bota bimore dhe shtazore, mirëpo edhe njerëzit të cilët jetojnë aty. Kjo normë gjithashtu është kompatible me sistemet e tjera të menaxhimit.

Organizatata/Kompania që mund të Certifikohen

Sipas kërkesave të normës ISO 14001, në parim, mund të certifikohet çfaredolloj organizate, mirëpo faktorët kyç për vendosur rreth Certifikimit janë veprimtaria, tregu I kërkuar I shitjes dhe qëllimet në sferën e raporteve me publikun.

Spektri i certifikimit

Përveç aspekteve të tjera, Certifikimi sipas ISO 14001 merr në shqyrtim:

- Politikën, qëllimin dhe programet e mbrojtjes së mjedisit
- Përmirësimi i vazhdueshëm i kërkesave ligjore dhe i rregulloreve dhe nenakteve të tjera lidhur me mbrojtjen e mjedisit.



Përparësitë e certifikimit

Aplikimi vullnetar për vendosjen dhe aktivizimin e Sistemit të Menaxhimit për Mbrojtjen e Mjedisit, mundëson parandalimin e rreziqeve të paparashikuara dhe ne te njëjten kohe jep mundësi të reja për zhvillimin e biznesit. Përparësia e certifikimit sipas ISO 14001 sjell rrezultate ne:

- Uljen e shpenzimeve përmes përmirësimit të vazhdueshëm të mjedisit
- Kursimet e resurseve natyrore (energjisë, ujit etj)
- Aplikimi me kohë i Masave të Mbrojtjes së Mjedisit
- Niveli të lartë të harmonizimit me ligjet dhe masat të vendosura me qëllim rritjen e besimit të blerësve, përfaqësuesve të pushtetit, si dhe publikut në përgjithësi
- Përbushja e kërkesave të blerësit lidhur me pikeveshtrimin pozitiv ndaj mjedisit (si parakusht për blerjen e produkteve apo shërbimeve)
- Përmirësimin e imazhit, si organizatë/kompani me vetëdije të lartë mbi rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit
- Uljen e rrezikut për ndotjen e mjedisit.

Know – how ynë, Suksesi Juaj

TÜV NORD është njëra ndër Entitetet më të Rëndësishme të Inspektimit dhe Certifikimit në botë. TÜV NORD GROUP është në shërbim të klientëve kudo që e kërkojnë aktivitetet e tyre të biznesit. Ekspertët dhe Auditorët tanë posedojnë një eksperiencë të madhe Prandaj dhe janë të punësuar Kjo siguron pavarësinë dhe paanshmërinë dhe gjithashtu do të thotë se mund t'u ofrojmë vazhdueshmeri në përkrahje të klientëve tanë. Dobia që ju vjen ju është e qartë: Auditorët tanë përcjellin dhe e përkrahin zhvillimin e organizatës tuaj dhe ju sigurojnë informacione objektive.

A jeni i interesuar?

**Ju lutemi të na përgjigjeni me fax ose e-mail.
Shpresojmë në përgjigjen tuaj.**

Dërguesi (me germa të shtypit)


Organizata/Kompania

Zonja/Zoti

Pozicioni i punës

Rruga dhe Numri

Rruga deri tek Certifikimi



**Po, jemi të interesuar për Certifikimin sipas ISO 14001
Ju lutemi të na kontaktoni**

Numri postar/Vendi

Telefon/Mobile

Fax

E-mail

Rep. TÜV NORD in Albania

Elvis Pazaj

Rruga Bardhyl 16

1005, Tirana, Albania

epazaj@tuv-nord.com

+355 6920 31015

+355 445 31015

www.tuv-nord.com

